



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.31, datë 25.01.2021

PËR

**KORRIGJIMIN E GABIMIT NË SHKRIM NË VENDIMIN NR. 8, DATË 14.01.2021,
TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative, me kërkesën e anëtares të Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Brunilda Kadi, në cilësinë e relatores në hartimin e “Projektraportit të vlerësimit të përshpejtuar etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2019”, pasi konstatoi gabimet në shkrim, në Raportin e Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarit”, bashkëlidhur vendimit nr. 8, datë 14.01.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Korrigjimin e gabimit në shkrim, në faqen 11 dhe faqen 15 të “Raportit të Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarit”, si me poshtë:

Në faqen 11 të Raportit të Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarit, në tabelën përmbledhëse të grup-kriterit “Aftësitë Organizative të Gjyqtarit”, niveli i vlerësimit i pasqyruar “Shumë mirë”, të korrigjohet në “Shkëlqyeshëm”.

Në faqen 15 të Raportit të Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarit, në tabelën përmbledhëse “Niveli i vlerësimit për çdo kriter”, pika 2 “Aftësitë organizative të gjyqtarit”, niveli i vlerësimit i pasqyruar “Shumë mirë”, të korrigjohet në “Shkëlqyeshëm”, si dhe “Niveli i përgjithshëm” i pasqyruar “Shumë mirë”, të korrigjohet në “Shkëlqyeshëm”.

2. Një kopje e këtij vendimi i bashkohet vendimit nr.8, datë 14.01.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Një kopje e vendimit t’i njoftohet gjyqtares {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR